

KËRKESË
Nr. 2605, datë 27.4.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikimi i fasadave të pallateve në Shëtitoren ‘Miqësia’ dhe rrugës së tregut, si dhe ‘Rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish-mapos’ Poliçan”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Poliçan.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në bazë të udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016”, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është 9,130,543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

